

FJALA E DEPUTETIT BLENDI KLOSI

E ENJTE 10 NËNTOR 2022

Projektbuxheti, në fakt, është diskutimi më i rëndësishëm parlamentar, është raporti i këtij parlamenti, i kësaj maxhorance, i kësaj qeverisjeje, në fakt, i të gjithë qeverisjes dhe i politikës së vendit me qytetarët.

Kryefjala e buxhetit është besimi. Sa besim krijojmë ne me ato që bëjmë, me ato që themi, me ato që debatojmë pozitë-opozitë te qytetarët e thjeshtë? Kryefjala e këtij buxheti është besimi që u kërkojmë qytetarëve, që të na besojnë, sepse ne jemi me ta përballë një krize të re që shfaqet jo vetëm në Shqipëri, por në të gjithë rajonin tonë. Kërkojmë besim se si Parti Socialiste, si parti e majtë, do të vazhdojmë të kujdesemi për të gjithë njerëzit e thjeshtë dhe të zakonshëm të këtij vendi, për ata njerëz, të cilët kanë nevojë për këtë mbështetje, kanë nevojë të kuptojnë që ky buxhet, një pjesë të madhe të tij, do ta çojë drejtpërsëdrejti te këto familje. Kanë nevojë të besojnë se në këtë dimër që po shfaqet në horizont, do të kenë pranë një përkujdesje shtetërore, aq sa ajo është, brenda këtij besimi.

Ne kërkojmë që njerëzit të kuptojnë se nuk jemi një vend i pavarur. Tashmë është buxheti i parë i një vendi që ka hapur negociatat me Bashkimin Europian. Për herë të parë ne kemi këtë buxhet qeverisës, i cili është një partneritet edhe te pjesa e besimit, pa dyshim ky buxhet nuk mund të jetë i ndërtuar nga besimi që ne kemi me aleatët tanë euro-atlantikë, nga besimi që ne duhet t'i japim nëpërmjet politikave tona një vendi, i cili është shumë i vogël në Europë për të ndikuar në të gjithë krizën globale të këtij kontinenti, por padyshim influencohet nga kriza e shkaktuar nga lufta në Ukrainë.

Ne jemi qartazi në një besim me aleatët tanë euro-atlantikë. Jemi qartazi në këtë luftë. Jemi qartazi në këtë përpjekje. Prandaj, buxheti i shtetit duhet kuptuar si mekanizëm për t'iu afruar qytetarëve. Ju e diskutuat sot dhe, në fakt, besoj do të kemi mundësinë të shohim edhe votimin që do të ndodhë, se nuk presim të kemi një opozitë që do të votojë buxhetin, mirëpo duhet të kemi një opozitë, e cila duhet të diskutojë për buxhetin. Kjo duhet të ndodhë, por nuk ka për të ndodhur as sot, nuk ndodhi as gjatë këtyre ditëve. Po ç'rëndësi ka! Nuk dua të hyj në debat me ju, por dua të them fare qartë se ky besim që krijohet nga këta mekanizma shtetërore, një vit më parë u vërtetua në përballjen elektorale. Ne, edhe pse dolëm nga pandemia, edhe pse dolëm nga një krizë e madhe jo vetëm shqiptare, por globale, përsëri morëm mandatin e tretë, sepse punojmë për njerëzit, qeverisim për njerëzit, bashkëbisedojmë

me njerëzit, qajmë hallet dhe shqetësimet e tyre. Kjo u provua një vit më parë, se këtë besim na e dhanë njerëzit.

Unë kam fatin, nderin dhe respektin e kësaj partie të bëj jetën politike në Vlorë. Është një qark që realisht meriton të diskutohet se çfarë bëjmë ne me politikën tona, për të krijuar besim tek ata njerëz. Çfarë kemi parashikuar ne edhe në këtë buxhet për të plotësuar investimet e mëdha publike për atë qark, që të marrim nga ata njerëz besimin? Besimi është gjëja më e rëndësishme që ne duhet të krijojmë në raport me qytetarët. Investimet publike për të ndërtuar rrugën Fier-Vlorë; për të ndërtuar bajpasin e Vlorës; për të investuar në tunelin e Llogarasë apo tunelin e rrugës Kardhiq-Delvinë-Sarandë. Investimet e “Rilindjes urbane” në të gjithë këtë territor a kanë prodhuar besim? A kanë prodhuar transformim të këtij qarku? A kanë prodhuar rritje të ekonomisë në këtë qark? Ky është besimi që duhet të krijojmë me politikën tona.

Le t’i marrim gjërat me radhë! Le të kuptojmë se çfarë kanë krijuar këto investime publike. A janë shtuar investimet pas kësaj politike të qeverisë shqiptare për rritjen e investimeve të qenësishme në fushën e transformimit të territoreve tona në zona që prodhojnë ekonomi? A kanë prodhuar shumë më tepër investime private në hoteleri? A kanë besuar këta investitorë te kjo politikë, te ky buxhet? Po, kanë besuar. Në të gjithë qarkun, në të gjithë Shqipërinë ka investime të qenësishme në hoteleri.

A kanë besuar banorët e zonave rurale në politikën e qeverisë shqiptare për të transformuar vendin tonë, jo vetëm në zona ku prodhohet vetëm për komunitetin, por për transformimin e Shqipërinë në një prodhues global, për të pasur mundësinë, që duke u bashkuar të kemi mundësinë të eksportojmë, të kemi partneritet me atë që kemi krijuar së bashku, me besim te partnerët tanë ndërkombëtarë?

Po të shikoni, kudo në Shqipëri, në zonat tona rurale apo urbane, ka prodhues të rinj, të cilët tashmë e kanë kuptuar se vlera e këtij vendi është ajo e bashkëpunimit me partnerët, me ekonomi të ndryshme.

A kemi krijuar besim në qarkun e Vlorës për investime të qenësishme? Ky është debati që duhet të bëjmë. Ne duhet të kuptojmë se çfarë prodhon ky projektligj. Çfarë prodhon ky projektbuxhet? A krijojmë besim? Besimi është tek investimi. Besimi është tek energjia. Besimi është tek ajo që ata investojnë dhe prodhojnë.

Në qarkun e Vlorës ka investime të qenësishme, të cilat nuk mund të vinin në rast se ne nuk do të krijojmë buxhet dhe nuk do të krijojmë mundësinë gjatë këtyre dhjetë vjetëve të administrimit të

pasurisë publike për investime qindra milionë euro, të cilat vijnë në Aeroportin e Vlorës, një investitor privat.

Beson investitori te kjo maxhorancë. Beson investitori te kjo qeveri. Beson investitori te këto ligje, për të investuar mbi 100 milionë euro për Aeroportin e Vlorës. Besojnë investitorët, besojnë në ekonominë e Vlorës, të Sarandës, të Dhërmiut, të Himarës për të investuar dhjetëra e qindra milionë euro në Portin e Vlorës, në Portin e Sarandës. Besojnë investitorët, besojnë tek ekonomia dhe te kjo maxhorancë. Këtë duhet të krijojmë ne, duhet të krijojmë besimin që duke investuar në ekonomi, ne të prodhojmë ekonomi.

Dhe e fundit, meqenëse doni të merreni me politikë, ky projektligj ka prodhuar edhe një besim tjetër.

Më dëgjoni, se me ju e kam.

Ka krijuar besimin se ju do të humbni. E dini se ku evidentohet kjo? Me disa kolegë kemi shumë vjet në parlament, por kurrë nuk ka ndodhur që të bëjmë mbledhje komisioni, ku të jetë e pranishme vetëm maxhoranca për të diskutuar projektligjin për buxhetin dhe të mos ketë asnjë përfaqësues të opozitës.

Kurrë nuk ka ndodhur që në diskutimet parlamentare të tërhiqen 15 deputetë të opozitës. Nuk keni besim se realizoni ndonjë gjë. Nuk keni asnjë garanci që do të fitoni në ndonjë bashki, edhe në garën e ardhshme elektorale. Ky është besimi.